

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"My Albania News" SHPK**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe të Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" me vullnetin e tij të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e Statutit vendosi të formojë shoqërinë:

**I. THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria "My Albania News" SHPK themelohet nga ortaku i vetem Z. Dritan Gremi, shtetas shqiptar, lindur më 15.04.1976, në Elbasan dhe banues në Tirane, me numër karte identiteti H60415099F
- 1.2

**II. EMRI. SELIA. FORMA LIGJORE**

**Neni 2**

**Emri i shoqërise**

- 2.1 Emri i shoqërisë është " My Albania News " SHPK.

**Neni 3**

**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), në bazë të ligjit Nr.9901, date14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria "My Albania News" SHPK, do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Ligjin nr. 9901, date14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe dispozitat e tjera të Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një kohë mbi 10 vjet .  
5.2 Veprimtaria e Shoqërisë fillon që nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

#### **Neni 6** **Selia**

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Nr pasurie 1/118-N23, ZK 8380, volumni 18, fq 209, Tirane  
6.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.  
6.3 Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë, filiale ose/dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë vendit.  
6.4 Shoqëria mundë të marrë pjesë në shoqëri të tjera ekzistuese ose në shoqëri që në të ardhmen do të zhvillojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij me vendim të ortakeve të saj.

#### **Neni 7** **Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj që do të përdoret nga administratori.  
7.2 Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Ortakët e shoqërisë, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

#### **Neni 8** **Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë:

Kryen aktivitetet në fushën e medias vizive dhe të shkruar online: lajme, video, portal online, podcast.

#### **Neni 9** **Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar është 1.000 (njëmijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë si më poshtë:

1. Z. Dritan Gremi, 1 kuotë me vlerë 1.000 (njëmijë) lekë dhe me pjesëmarrje 100% të kuotave të kapitalit.

- 9.2 Kapitali do të derdhet tërësisht me aktin e themelimit. Asambleja mund të marrë vendim për rritje të kapitalit, duke përcaktuar afatin, kushtet dhe modalitetet. Kapitali mund të shtohet nëpërmjet akordimit të pasurive në natyrë apo kredite.

Në interesin financiar të shoqërisë ortaku i vetëm mund të kryejnë derdhje pa interes në llogari kapitale, si edhe financime me apo pa interes, duke respektuar ligjin.



Shoqëria mund të procedoj me rimbursime të financimit, të pjesshme apo totale, mbledhjen e fondeve nga ortakët/u, me të drejtë rimbursimi, duhet tu drejtohet ekskluzivisht subjekteve që janë në perputhje me kërkesat e ligjit dhe rregulloreve, sipas rregullave të autoriteteve perkatëse.

#### **Neni 10**

#### **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

- 10.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial.
- 10.2 Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të tretëve me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë. Pjesët e kapitalit transferohen në rrugë trashëgimnie pasi të jetë marrë vendimi i Ortakut të vetëm lidhur me kalimin e pjesëve të kapitalit tek trashëgimtarët.

#### **Neni 11**

#### **Zmadhimi / Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 11.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të tij. Zvogëlimi i kapitalit themeltar do të kryhet brenda kufijve të lejuar nga ligji.

### **ORGANET E SHOQËRISË**

#### **Neni 12**

#### **Asambleja e Ortakut të Vetëm**

Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

- 12.1 Asambleja e Ortakut të Vetëm drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Mbledhjet e Asamblesë janë të zakonshme.

#### **Neni 13**

#### **Asambleja e Zakonshme**

- 13.1 Asambleja e zakonshme vendos në çdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo merr të gjitha vendimet (emërimi dhe shkarkimi i administratorit/ëve, miratimin e bilancit të shoqërisë, etj.) me përjashtim të atyre vendimeve që në bazë të ligjit ose Statutit janë në kompetencë të Asamblesë së Jashtëzakonshme.
- 13.2 Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortakët e saj me 51% të votave.

#### **Neni 14**

#### **Thirrja dhe Përfaqësimi në Asamble**

Mbledhja e Asamblesë së Ortakut të Vetëm mund të thirret në çdo kohë nga:

- Administratori;
- Ortaku i Vetëm.
- E të tjerë konform ligjit



**Neni 15**  
**Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve**

- 15.1 Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër të njoftuar nga administratori/njëri prej administratorëve.
- 15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande, dhe postë tjetër të regjistruar, të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

**Neni 16**  
**Marrja e vendimeve**

- 16.1 Vendimet merren nga ortakët e saj me 51% te votave.


**Neni 17**  
**Administrimi**

- 17.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose nga një grup administratorësh që caktohet nga Asambleja e Ortakut Të Vetëm.
- 17.2 Administratori nuk është detyrimisht ortakë i shoqërisë.
- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe të drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- 17.4 Administratori është solidarisht përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendës.
  - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendës, veçanërisht në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera të kreditit, për hapjet e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
  - përgatitjen e mbledhjeve të Asambleve të Ortakut të Vetëm;
  - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vetë ose emërimin e një kontabilisti të miratuar ose të një eksperti kontabël;
  - përgatitjen e dokumenteve në emër të shoqërisë sipas kompetencave që ka;
  - lidh kontrata pune dhe i zgjidh ato sipas rastit;
  - zhvillon veprimtari të tjera të cdo lloji natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
- 17.5 Shoqëria do të administrohet nga administratori dhe njëkohësisht dhe ortak i vetëm Z. Dritan Gremi i cili emerohet ne kete detyre per nje afat kohor prej 5 (pese) vjet.

**Neni 18**  
**Viti financiar**

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar në 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

**Neni 19**  
**Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit**



- 19.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm dhe i paraqitet organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 19.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën Shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të vecanta në valutë.
- 19.3 Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët, institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

**Neni 20**  
**Të ardhurat. Dividendi**

- 20.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e objektit të saj.
- 20.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të terhiqen nga ortakët e vetëm të shoqërisë.

**Neni 21**  
**Likuidimi**

- 21.1 Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit, nëse:
- gjendja ekonomike në Shqipëri nuk do të lejojë vazhdimin e veprimtarisë së shoqërisë;
  - Asambleja e Ortakut të Vetëm, vendos të prishë shoqërinë.
- 21.2 Në mënyrë që të ndërmerret procedurat e likuidimit, Asambleja e Ortakut të Vetëm emëron një likuidator ose një grup likuidatorësh.
- 21.3 Likuidatori/likuidatorët raportojnë mbi gjendjen e zërave të aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakut të Vetëm shqyrton bilancin përfundimtar dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

**Neni 22**  
**Dispozita mbyllëse**

- 22.1 Ky Statut hartohet në 5 (pesë) kopje me fuqi të njëjtë ligjore në gjuhën Shqipe, për tu depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit e për tu shpërndarë në organet Kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tirane me 20.12.2023

**ORTAKU I VETËM**

**Dritan Gremi**

